



Në bazë të dispozitave të nenit Nenit 26 pika 4 të Statutit të Ndërmarrjes Publike Banesore si dhe Nenit 3, 4 dhe 5 të Rregullores mbi dhënien me qira të pasurive komerciale të ndërmarrjes publike banesore, SH.A. Prishtinë, Ndërmarrja Publike Banesore SH.A. Prishtinë shpallë:

FTESË PËR APLIKIM PËR MARRJE TË PRONAVE ME QIRA

Ftoheni që të aplikoni për marrje në shfrytëzim me qira të lokaleve afariste, depove dhe garazhave pronë e Ndërmarrjes Publike Banesore, SH.A. Prishtinë. Pronat e poshtëpërmendura u ipen me qira personave juridik, përveç garazhave të cilat mund t'u ipen në shfrytëzim edhe personave fizik.

Pasuritë komerciale të cilat ipen me qira:

Nr.	Adresa	Sipërfaqja	Çmimi €/m ² (pa TVSH)
1	Lokali 9/18, Rr.Kosta Novakoviq (Përball Hotel Prishtinës)	87.08 m ²	6
2	Lokali 18/11, Lagja Dardania (Afer zyrate të AKB)	48.41 m ²	5
3	Lokali 18/10, Lagja Dardania (Ish zyrat e AKB)	40.02 m ²	5
4	Lokali 18/8, Lagja Dardania (Tek pllatoja mbi Xhamin e Dardanis)	23.07 m ²	5
5	Lokali 18/5, Lagja Dardania (Mbi kurriz)	61.65 m ²	5
6	Lokali 3/12, Rr. Ylfete Humolli (mbrapa objektit të inspeksionit komunal)	22.93 m ²	8
7	Lokali 3/20, Rr. "Ylfete Humolli" (mbrapa objektit të inspeksionit komunal)	22.23 m ²	8
8	Lokali 6/22, Rr. "Adrian Krasniqi" (Te ambasada e Zvicërres)	59.31 m ²	9
9	Lokali 15/4, Rr. "Xhavit Mitrovica" (Afer parkut të qytetit)	13.54 m ²	5
10	Lokali 15/10, Rr. Xhavit Mitrovica (Afer Parkut të Qytetit)	16.73 m ²	5
11	Lokal 20/16, Lagja Ulpiana (Afer Fontanës në Ulpianë)	61.92 m ²	7
12	Depo 19/3a, Lagja Lakrishtë (Afer Autoskolles Instruktori)	156.58 m ²	4
13	Depo 21/12, Lagja Lakrisht (Mbrapa zyrate të NPB-së)	105.72 m ²	3
14	Depo 21/9, Lagja Lakrisht (Mbrapa zyrate të NPB-së)	64.74 m ²	4.6
15	Depo 21/13, Lagja Lakrisht (Mbrapa e zyrate të NPB-së)	217.74 m ²	2.5
16	Lokali 22/66. Rr. "Agim Ramadani"	31.64 m ²	8.5
17	Trualli 21/50, Rr. "Bill Clinton" (Afer zyrate të NPB – re)	321.61 m ²	0.8
18	Depo 24/2, Rr. Eqrem Qabej (Afer semaforave kryesor në Prishtinë)	188 m ²	1.5

Përveç çmimit bazë, qiramarrësi do të paguaj TVSH-në, shërbimet e mirëmbajtjes dhe obligimet komunale.

Periudha e Qiradhënies është për 1 vit, me mundësi vazhdimi.

Qiramarrësi është i obliguar që para nënshkrimit të kontratës me qiradhënësin, të bëjë sigurimin e kontratës së qirasë për gjashtë muaj më gjatë se vetë kontrata, në shumë prej tri qirave mujore neto.

Parametrat që do të shërbejnë për përzgjedhjen e aplikuesëve:

1. Lloji i investimit më të volitshëm;
2. Sektori investues;
3. Numri i të punësuarve nga investimi;
4. Plani/ Përshkrimi i Biznesit;
5. Kohëzgjatja e veprimtarisë së biznesit;
6. Vendi i veprimtarisë së biznesit;

Aplikuesi duhet t'i dorëzoj këto dokumenta:

1. Aplikacionin për marrjen e lokaleve me qira (mund ta merrni në hapësirat e NPB-së);
2. Kopjen e certifikatës së regjistrimit të bashkangjitur me informatat e biznesit;
3. Kopjen e certifikatës së TVSH-së nëse është deklarues i TVSH-së;
4. Kopjen e certifikatës Fiskale;
5. Numrin e xhironlogarisë bankare të biznesit;
6. Plani/ Përshkrimi i Biznesit;
7. Kopjen e një dokumenti identifikues të pronarit ose të përfaqësuesit të biznesit;
8. Vërtetimin që nuk është nën hetime;
9. Vërtetimin nga ATK-ja për pagesën e obligimeve tatimore;
10. Fletëpagesën për aplikim.

Aplikacioni duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur. Në zarf (jashtë) duhet të specifikohet: emri i aplikuesit, nr. intern i patundshmërisë dhe kontaktet e aplikuesit (emaili dhe nr. i telefonit).

Tarifa e aplikimit: 10 € (Euro). Kont: BKT 1909466981031194

Aplikacionet nuk do të merren parasysh nëse:

- Aplikuesi tashmë e ka një lokal me qira nga Ndërmarrja Publike Banesore SH.A.Prishtinë;
- Aplikuesi ka pasur lokal me qira nga Ndërmarrja Publike Banesore dhe nuk i është përmbajtur kontratës së qirasë ose ka obligime ndaj Ndërmarrjes;
- Nëse aplikohet për bizneset veprimtaria e të cilave është e ndaluar me ligj në hapësirat përkatëse;
- Nëse aplikacioni nuk i përmban të gjitha dokumentet e kërkuara;
- Nëse aplikacioni arrinë pas datës së skadimit të afatit të publikimit të shpalljes.

Personat të cilët duan t'i vizitojnë lokalet me praninë e zyrtarëve të NPB-së, si dhe të kenë qasje në hapësirat e brendshme të tyre, këtë mund ta bëjnë me datën dhe orarin si në vijim:

Numri i lokalit(sipas renditjes në tabelë)	Data	Periudha kohore
1, 2, 3, 4, 5	16.03.2017	09:00 – 15:00
6, 7, 9, 10	17.03.2017	09:00 – 15:00
8, 11, 16, 17	20.03.2017	09:00 – 15:00
12, 13, 14, 15, 18	21.03.2017	09:00 – 15:00

Afati për aplikim është i hapur nga data 13.03.2017 deri më date 27.03.2017

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në këtë adresë: Ndërmarrja Publike Banesore-SH.A. në Prishtinë, Bulevardi “Bill Clinton” nr. 32, Prishtinë.